



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

**MINISTRISË SË KULTURËS  
SEKTRETARIT TË PËRGJITHSHËM**

Ju përcjellim Analizën Vjetore të Institutit Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë  
Kulturore për vitin 2020.

**DREJTORI**

**Silva Breshani**



**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

**ANALIZA VJETORE**

**2020**

**1. OBJEKTIVAT DHE REALIZIMET PËR VITIN 2020**

Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore në përmbushje të misionit të saj për dokumentimin e saktë shkencor të pasurive kulturore, inventarizimin, ruajtjen, katalogimin informatik të trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar në databazën kombëtare të pasurive kulturore, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes, me qëllim identifikimin, ruajtjen, studimin, botimin dhe promovimin e tyre, si dhe në zbatim të Ligjit Nr.27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” Ligjit 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat” si dhe VKM Nr. 945, datë 2.11.2012 “Për miratimin e rregullores dhe administrimit të sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, VKM Nr. 278 datë 16.05.2018 “Pë krijimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK), si dhe të gjitha akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të lidhura me të, ka hartuar dhe realizuar Planin Operacional 2020 duke përcaktuar objektivat dhe produktet bazuar në tre shtylla kryesore:

- A. Bashkëpunimi Ndërinstitucional për përditësimin dhe mirëadministrimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore RKPK”.
- B. Monitorimi fizik dhe civil i qarkullimit kombëtar dhe ndërkombëtar i pasurive kulturore si dhe pronësisë mbi objektet
- C. Marrëveshjet kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të luftës kundër trafikimit të Trashëgimisë Kulturore

**VEPRIMTARIA E IKRTK:**

1. IKRTK-ja e shtrin veprimtarinë e tij për trashëgiminë kulturore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në:
  - a) nivel qendror të regjistrimit të trashëgimisë kulturore, nëpërmjet drejtorisë qendrore;
  - b) nivel rajonal, nëpërmjet zyrave rajonale të IKRTK-së dhe zyrave të eksportit të pasurive kulturore të luajtshme, të cilat funksionojnë pranë DRTK-ve.
2. IKRTK-ja menaxhon aktivitetin e zyrave rajonale dhe zyrave të eksportit të pasurive kulturore të luajtshme, sipas parashikimeve të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe të muzeve.
3. Pranë IKRTK-së funksionon Komisioni Këshillimor për Vlerësimin dhe Identifikimin e Vlerave Kulturore në pasuritë e luajtshme.
4. IKRTK-ja, në ushtrimin e veprimtarisë së saj ka këto detyra dhe përgjegjësi:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

- a) Të organizojë punën për realizimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësisë në:
- i. regjistrimin, katalogimin informatik, dokumentimin, vlerësimin e promovimin e trashëgimisë kulturore;
  - ii. monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë e të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë;
  - iii. ofrimin e shërbimeve organeve të administratës shtetërore qendrore, të pushtetit vendor, të institucioneve shkencore, kulturore apo fetare, të personave fizikë e juridikë privat për evidentimin, regjistrimin dhe katalogimin e pasurive kulturore;
  - iv. dokumentimin sipas kriterëve shkencore të trashëgimisë kulturore, të mbikëqyrë e të monitorojë respektimin e të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes, me qëllim identifikimin, studimin, botimin dhe promovimin, ruajtjen e administrimin e database-it kombëtar të pasurive kulturore dhe të kontribuojë për rritjen e ndërgjegjësimit, me qëllim ruajtjen dhe promovimin e pasurive kulturore në nivel kombëtar.
- b) Regjistron e dokumenton të gjitha pasuritë kulturore, material dhe jomateriale, si dhe pasuritë e peizazhit në pronësi publike e private në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- c) Regjistron në kartelat e pasurive kulturore vendimet e këshillave kolegjalë të trashëgimisë kulturore; Regjistron transferimet e pasurive kulturore ndërmjet pushtetit qendror dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore ose të institucioneve të tjera publike vendore;
- ç) Regjistron lejet për ndërhyrjet ruajtëse të miratuara nga KKTKM-ja;
- d) Regjistron masat e mbrojtjes indirekte në regjistrat e pasurive;
- dh) Regjistron objektet muzeore, koleksionet, si dhe lidhjen ose jo të objekteve muzeore me koleksionet, që janë pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore;
- e) Harton platformën për regjistrimin e të gjitha pasurive kulturore të luajtshme e të paluajtshme, që ruhen nga rrjeti muzeor i vendit, nga galeritë e artit, personat privat, institucionet e specializuara vendore e kombëtare dhe bashkësitë fetare të regjistruara me ligj, për krijimin dhe përditësimin e Regjistratit Kombëtar të Pasurive Kulturore;
- ë) Harton dhe mban regjistrin e ekspertëve vlerësues të pasurive kulturore të luajtshme;
- f) Harton masat për ruajtjen, mbrojtjen, mirëmbajtjen, administrimin, tjetërsimin e qarkullimin e objekteve muzeore dhe të koleksioneve muzeore me propozim të përbashkët me IKTK-në;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**


- g) Administron Katalogun Kombëtar të Pasurive Kulturore, nëpërmjet sistemit informatik kombëtar të administrimit të trashëgimisë kulturore, si dhe regjistrat kombëtarë të vlerave kulturore materiale e jomateriale;
- gj) Administron katalogun e Fondit Muzeor Kombëtar;
- h) Administron bazën shtetërore të të dhënave të pasurive kulturore;
- i) Administron bazën e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura;
- j) Asiston ministrinë në ushtrimin e kompetencave për zbatimin e politikave qeveritare në fushën e trashëgimisë kulturore për funksionet që IKRTK-ja ka kompetencë;
- k) Administron e përditëson Regjistrin Kombëtar të Pasurive Jomateriale dhe të Pasurive Materiale, në përputhje me seksionet përkatëse të pasurive kulturore të paluajtshme, si dhe të pasurive kulturore të luajtshme e të koleksioneve;
- l) Administron një Regjistër Kombëtar të Licencave të Eksportit të Pasurive Kulturore;
- ll) Administron Regjistrin e Tregtimit të Pasurive Kulturore;
- m) Administron një kopje të dokumentacionit të marrjes në dorëzim të punimeve të ndërhyrjeve në pasuritë e paluajtshme;
- n) Administron një kopje të listës së lejeve të ndërhyrjeve në pasuritë e peizazhit;
- nj) Lëshon certifikata regjistrimi të pasurive kulturore, të luajtshme e të paluajtshme dhe, në rast të humbjes së saj, lëshon një dublikatë;
- o) Lëshon dokumentacionin për ekzistencën e objekteve muzeore në muze, për krijimin dhe regjistrimin e muzeve ekzistues e të rinj;
- p) Lëshon vërtetim për kopjet e autorizuara të çdo objekti muzeor;
- q) Mbikëqyr e monitoron respektimin e të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare;
- r) Mbikëqyr zbatimin apo shkeljen e procedurave (regjimit) të qarkullimit kombëtar dhe ndërkombëtar të certifikuar të pasurive kulturore të luajtshme;
- rr) Asiston dhe denoncon pranë inspektoratit përgjegjës për trashëgiminë kulturore;
- a) Zhvillon metodologjinë për dokumentimin e katalogimin e pasurive kulturore, si dhe koordinon bashkëpunimin me njësitë territoriale në fushën e pasurive kulturore;
- sh) Kryen regjistrimin on-line të pasurive kulturore kombëtare dhe të çdo procedure për identifikim e regjistrim;
- b) Monitoron procedurat e eksportit për qarkullimin kombëtar e ndërkombëtar, të certifikuar, të pasurive kulturore të luajtshme, në bashkëpunim me institucionet doganore dhe Policinë e Shtetit. Parashikon masat e nevojshme, me qëllim që pasuritë të mos pësojnë dëmtime gjatë transportit në rastin kur mbajtësi i pasurive



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

- kulturore ndryshon vendbanimin ose selinë, ndryshim, i cili deklarohet paraprakisht në drejtorinë rajonale të trashëgimisë kulturore përkatëse;
- th) I propozon ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore mundësinë e parablerjes së pasurive kulturore;
- u) Koordinon procesin e pasqyrit të të dhënave në regjistrat e tjerë publikë për pasuritë e trashëgimisë kulturore të deklaruara;
- v) Miraton çdo vit listën e çmimeve të referencës për pasuritë kulturore;
- x) I jep mendim Këshillit Kombëtar të Muzeve për përcaktimin e vlerës maksimale të transaksionit për pasurimin e fondit muzeor;
- xh) Ndjek dhe Monitoron procedurat e lidhura me Licencimin e Tregtarëve të Pasurive Kulturore.
- z) çdo detyrë tjetër të përcaktuar me ligj.
5. Zyrat Rajonale të IKRTK-së dhe zyrat e eksportit të pasurive kulturore të luajtshme kanë për detyrë:
- a) Regjistrimin on-line të pasurive kulturore kombëtare dhe çdo procedure për identifikim dhe regjistrim;
- b) Zbatimin dhe monitorimin e procedurave të eksportit për qarkullimin kombëtar e ndërkombëtar, të certifikuar, të pasurive kulturore të luajtshme, në bashkëpunim me institucionet doganore dhe Policinë e Shtetit



**1.1 OBJEKTIVA IKRTK JANAR-DHJETOR 2020**



## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

### A. Bashkëpunimi ndërinstitucional për përditësimin dhe mirëadministrimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore RKPK”.

- Parashikuar të regjistrohen 100 000 objekte pasuri kulturore në administrim të Institucioneve Publike/ Private.
- Unifikimi i Emërtesave dhe Institucioneve Publike/ Private (emërtesat zyrtare/ muze kombëtarë/okalë/privatë/ institucione që administrojnë fonde të pasurive kulturore/ funksional/ dhe jo funksional) që kanë në administrim dhe regjistruar fonde të pasurive kulturore në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)” me qëllim hartimin dhe përditësimin e Inventarit të Fondit Muzeor Kombëtar si dhe verifikim e regjistrave dhe inventarëve që administrohen nga këto Institucione (Ka filluar procesi me Bashkitë dhe Institucionet).
- Koordinimin dhe bashkëpunim me AKSHI-n për hartimin e ToRs për përditësimin dhe shtimin i moduleve të reja në Bazën Shtetërore të të Dhënave "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore referuar Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.
- Koordinimin dhe bashkëpunim me AKSHI-n dhe Drejtorinë Juridike për një ndryshim në VKM Nr.278, datë 16.05.2018 “Për Krijimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK), ndryshimi i tog-fjalshit nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Pasurive Kulturore.
- Administrimi i Katalogut Kombëtar të Pasurive Kulturore, nëpërmjet sistemit informatikë kombëtar të administrimit të trashëgimisë kulturore, digjitalizimi dhe indeksimi i Regjistrave Themeltar të Fondit Muzeor Kombëtar.
  - Pjesë e Bazës së të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK) është Mooduli i Indeksimit të Regjistrave Themeltarë të Muzeve që mundëson të dhënat e objektit të regjistruar të lidhur me me faqen ku është objekti në regjistrin themelatr. Do të mundësohet digjitalizimi dhe indeksimi regjistrave themeltar pjesë e fondeve muzeore, të:
    - Muzeut Historik Kombëtar
    - Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura, Tiranë (GKA)
    - Qendrës Muzeore Krujë
    - Qendrës Muzeore Berat
    - Qendrës Muzeore Durrës
    - Fondet Arkeologjike Tiranë
    - Fondet Arkeologjike Durrës.
- Inspektimet në terren të institucioneve që posedojnë dhe administrojnë fonde të pasurive kulturore, referuar përgjegjësive që rrjedhin në zbatim të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.



## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Rritja e standardeve për Shërbimin që ofrohen nga IKRTK për personat fizik juridik publik/privat qytetarët. Përditësimi i shërbimeve On-line

- Bashkëpunim me AKSHI-n dhe ADISA për përmisimin e standardeve të shërbimeve on-line.
  - Identifikimi dhe hartimi i moduleve dhe dokumentacionit për shërbimet e reja të IKRTK, si dhe shërbimeve online për aplikim të procedurave, aktualisht 3 (të cilat do ndryshojnë në emërtim në zbatim të Ligjit 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë".
  - Të planifikuara përgjatë 2021 – gjithsej 7 shërbime.

Shërbimet e reja:

1. Leje për zhvendosje të veprave të artit në të Poseduesve Privat.
2. Apikimi për Licencat e import/eksportit të pasurive kulturore.
3. Deklarimi i objekteve të humbura apo vjedhura të Poseduesve Privat.
4. Aplikimi për licencat e tregtarëve të pasurive kulturore.

### **B. Monitorimi fizik dhe civil i qarkullimit kombëtar dhe ndërkombëtar i pasurive kulturore si dhe pronësisë mbi objektet**

- Monitorimi i qarkullimit kombëtar dhe ndërkombëtar i pasurive kulturore si dhe pronësisë mbi objektet.
  - Ndjekja dhe zbatimi i qarkullimit fizik dhe civil të pasurive kulturore.
  - Në bashkëpunim me institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore, krijon bazën e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të dala në mënyrë të paligjshme në ose nga territori i Republikës së Shqipërisë. Baza e të dhënave administrohet sipas procedurave dhe mënyrave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Lufta kundër trafikimit të pasurive kulture.
  - Zbatimi i Konventës së UNESCO-s 1970, "Mbi mjetet e ndalimit dhe parandalimin e transportit ilegal, eksportin dhe transferimin e Pronësisë së Pasurisë Kulturore", ratifikuar me ligjin nr. 8523, datë 9.9.1999, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për mjetet e ndalimit dhe të parandalimit të importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë së pasurisë kulturore".
- Krijimi i hapësirave dhe bashkëpunimit ndërinstytucional për zbatim të përgjegjësiwe Institucionale që rrjedhin nga Ligji 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" dhe me Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 432 datë 26.06.2019 "Për



## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore”<sup>1</sup>

- Vënia në zbatim e zyrave rajonale të IKRTK-së, të cilat funksionojnë pranë DRTK-ve dhe janë të shpërndara në të gjithë vendin në nivel qarku, dhe kane për detyrë:
  - a) regjistrimin on-line të pasurive kulturore kombëtare dhe çdo procedure për identifikim dhe regjistrim;
  - b) zbatimin dhe monitorimin e procedurave të eksportit për qarkullimin kombëtar e ndërkombëtar, të certifikuar, të pasurive kulturore të luajtshme, në bashkëpunim me institucionet doganore dhe Policinë e Shtetit.
- Hartimi i ToRs për Krijimin dhe administrimi i bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura. (IKRTK/AKSHI/MK)
- Funksionimi pranë IKRTK-s i Komisionit Këshillimor për Vlerësimin dhe Identifikimin e Vlerave Kulturore në pasuritë e luajtshme
- Krijimi dhe administrimi i Regjistrit të Tregtimit të Pasurive Kulturore
- Akordimi i licencave të eksport importit, si dhe krijimi dhe administrimi e regjistrit kombëtar të licencave të eksportit të pasurive kulturore

### C. Marrëveshjet kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të luftës kundër trafikimit të Trashëgimisë Kulturore

- Vazhdimësia e marrëveshjeve kombëtare në kuadër të paktit për universitetin.
  - Akordimi i një marrëveshje mes MK, IKRTK dhe Universitet të Historisë.
  - Përfshirja dhe angazhimi i studentëve të Universitetit të Arteve të asistojnë në procedurat e ndjekura nga IKRTK në zbatim të ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” lidhur me, njohjen e Institucionit, përgjegjësit e IKRTK-së dhe Bazës e të Dhënave Shtetërore, “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”, funksionet si dhe ndërlidhjet e saj.
- Vijimësia e projektit nga IPA Kombëtare me titull “Building capabilities of the Albanian Public Administration on free movement and fight against illicit trafficking of Cultural goods”.
  - Përafrimi i akteve ligjore dhe nënligjore shqiptare me atë të Unionit në fushën e luftës kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore dhe rishikimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Paligjshëm të Pasurive Kulturore (3 VKM/ 11 udhëzime Ministri)

<sup>1</sup> Aktivitetet e listuara janë jo vetë prioritete por emergjencë në funksion të përgjegjësive Institucionale për zbatim të kuadrit ligjor sipër cituar por që kërkojnë një vendimarrje mbi kompetencat e IKRTK.





## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

- Trajnimi teknik i stafit të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të tjera të interesuara, përfshirë Doganat, Policinë, Interpolin dhe Prokurorinë.
- Vijimin e bashkëpunimit me Ambasadën e SHBA-ve në Tiranë lidhur me asistencën teknike të fituar për plotësim të dokumentacionit lidhur me kërkesën për një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe SHBA, në zbatim të nenit 9 të konventës të UNESCO-s 1970 “Mbi mënyrat e ndalimit dhe parandalimit të importit, eksportit të paligjshëm dhe transferimit të pronësisë të pasurisë kulturore dhe konventës mbi ligjin për aplikimin e pasurisë kulturore”.
  - Plotësimi i dokumentacionit të kërkuar lidhur me Kërkesën për një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe SHBA, në zbatim të nenit 9 të konventës të UNESCO-s 1970 “Mbi mënyrat e ndalimit dhe parandalimit të importit, eksportit të paligjshëm dhe transferimit të pronësisë të pasurisë kulturore dhe konventës mbi ligjin për aplikimin e pasurisë kulturore”.
- Finalizimi i procedurave të shqyrtimit të kërkesës për rikthimin të Ikonave të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Praktika kërkon :
  - Ngritjen e Grupit ndërinstitucional MK/IKRTK/IKTK me qëllim vijimin e procedurave për shqyrtimin nga ana juridike të kërkesës bazuar në rekomandimet e grupit teknik të vlerësimit dhe në zbatim të Ligjit 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Vendimarrje në KKTKM dhe KKM lidhur me rikthimin apo mos aprovimit të kërkesës së palës maqedonase.
  - Finalizimin e dosjes së plotë me dokumentacionin përkatës nga Grupi teknik i punës.
  - Depozitimin e dosjes së plotë në Kryeministri me qëllim ngritjen e një grupi të ri pune ndërinstitucional me përfaqësues nga Ministrit përkatëse, Ministria e Kulturës, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë me qëllim finalizimin e procesit të kthimit
- Raportimi dhe ndjekjen e proceseve si institucion kontribuues GPNIE, për 3 kapitujt.
  - Kapitulli 1, “Lëvizja e lirë e mallrave (kulturor)”.
  - Kapitulli 3, “E drejta e vendosjes, liria për të ofruar shërbime”.
  - Kapitulli 29, Sistemi Doganor”.

### **1.2 REALIZIME IKRTK JANAR-DHJETOR 2020**

#### **1.2.a Sektori i Inventarizimit, Regjistrimit dhe Katalogimit të Pasurive Kulturore**


- ❖ *Administrimi dhe Regjistrimi në Bazën e të Dhënave Shtetërore, “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”;*



## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Përgjatë periudhës Janar- Dhjetor 2020, janë regjistruar gjithsej 100 689 objekte kundrejt totalit 100 000, nga të cilat:


- 100 407 Objekte në pronësi Shtetërore
- 282 Objekte në pronësi Private.



- ✓ Përditësimi i Bazës së të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”, verifikuar objekte referuar Regjistrave të Muzeut Kombëtar të Fotografisë “Marubi” dhe Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar Korçë – 50,000 objekte të verifikuara në RKPK.
- ✓ Indeksimi i regjistrave themeltar pjesë e fondit Muzeor Kombëtar- 23 Regjistra.
- ✓ Migrimi i objekteve në Bazën e të dhënave Shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)"- 99450 objekte
- ✓ Akses dhe ndërveprim i Institucioneve publike/private që administrojnë fonde të pasurive kulturore në bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”- 11 Institucione.
- ✓ IKRTK në bashkëpunim me Institutin e Arkeologjisë është në proces të procedurave për verifikimin dhe regjistrimin e objekteve arkeologjike pjesë e fondeve të IA referuar regjistrave themeltar (regjistrat themeltar para viteve 90’) të depozituar nga Instituti i Arkeologjisë në vitin 2015 pranë IKRTK-së.



## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE



### 1.2.b Sektori i Zyrave Rajonale të Regjistrimit, Eksportit dhe Antitrafikut të Pasurive Kulturore

- ❖ *Monitorimi i lëvizjeve, Qarkullimi kombëtar / ndërkombëtar i objekteve (TRANSAKSIONE / LEJE);*
  - ✓ Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore në zbatim të Ligjit nr.27/2018 “Për Trashëgimin Kulturore dhe Muzetë”, monitoron, regjistron, asiston në procedurat e ndryshme të qarkullimit kombëtar/ndërkombëtar të objekteve pjesë e pasurive kulturore,
- ❖ *Përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, janë kryer procedurat e regjistrimit në RKPK të Transaksione/Leje për 993 objekte pjesë e Pasurive Kulturore.*
  - ✓ Monitorimi i qarkullimit fizik dhe civil të objekteve pasuri kulturore përmes fushave Leje / Transaksion në RKPK (zhvendosje objektësh brenda dhe jashtë vendit) - 626 objekte
  - ✓ Përditësimi i objekteve përmes fushave Leje / Transaksion referuar vendimeve të Këshillit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale si dhe procedurave të tjera të ndjekura nga Institucionet e tjera (restaurime, rikonstruksione, sondazhe arkeologjike, riprodhime, deklarim interesi kulturore, etj.) -367 objekte



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS


INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

- ✓ Monitorimi i procedurave të eksportit për qarkullim kombëtar dhe ndërkombëtar, riverifikim i transaksioneve përgjatë periudhës 1995 - 2020. Ndjekur procedurat për verifikimin e leje/transaksioneve, komunikim me të gjitha institucionet që kanë në administrim objekte pasuri kulturore dhe që kanë kryer zhvendosje të tyre ndër vite me qëllim pasqyrimin e tyre në Bazën e të Dhënave Shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)".

❖ *Sekuestrimi i objekteve pasuri kulturore;*

IKRTK përgjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020 ka ndjekur procedurat lidhur me praktikat si vijojnë:

- ✓ Rishqyrtimin e procedurave të praktikës “Ikonat” në kuadër të kërkesës së Ministrisë së Kulturës të Republikës së Maqedonisë së Veriut për disa ikona që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.



*Foto: Ikona ( Praktika Thimjo*

- ✓ Praktika me IAKSA lidhur me deklarinimin humbur të objektit “Jelek”, pjesë e fondit në ruajtje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE




Foto: Objekt i humbur (Jelek )

- deklarimin të humbur të Objektivit në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”;
  - përgatitjen e dosjes së praktikës për Interpol Tiranën për deklarimin dhe regjistrimin e Objektivit në Bazën e të Dhënave të objekteve të humbura pranë Interpol;
- ✓ Sekuestrimi nga Drejtoria Vendore të Policisë, Durrës lidhur me objektet Objekt funeral me relief dhe Afmorë, përfunduar raporti final nga grupi i punës (Vendimi i Ekspertimit).



Foto: Objekte të sekuestruara (Amforë dhe Objekt Funeral)

- ✓ Praktika me Drejtorinë Vendore të Policisë, Durrës, lidhur me procedimin penal Nr. 2189 të vitit 2020, për një mendim të specializuar në lidhje me vlerën historiko-kulturore të një objekti “..kryq i vjetër metalik me zinxhir..”, hartuar raporti lidhur me verifikimin fizik të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE



*Foto: Objekt i sekuestruar (Kryq i vjetër metalik me zinxhir)*

- ✓ Praktika lidhur me heqjen e objektit “Kokës së Akleptus-Zeus” nga databasa e objekteve të humbura të INTERPOL Tirana, pas kthimit në origjinë (Republika e Shqipërisë) në bashkëpunim me Ambasadën Italiane



*Foto: “Koka e Akleptus-Zeus”*

- ✓ Hartimi i ToRs për Krijimin dhe administrimi i bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura. (IKRTK/AKSHI/MK)

Nr.	Hartimi ToRs në lidhje me modulet e mëposhtme:
1.	Shtimi i Katalogut Fondi Muzeor Kombëtar/Digjitalizimi i regjistrave të Fondeve Muzeore
2.	Shtimi i Regjistrimit Kombëtar të Licencave të Eksportit të Pasurive Kulturore
3.	Shtimi i Modullit Regjistri i Tregtimit të Pasurive Kulturore
4.	Përditësim i Certifikatës Elektronike e Pasurisë Kulturore
5.	Moduli Verifikimi dhe deklarimi i interesit kulturor



## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

6.	Shtimi i Regjistrimit Kombëtar i Pasurive Kulturore të Vjedhura
7.	Përditësim i Moduleve ekzistuese
8.	Trajnime të stafëve përgjegjëse

**Më poshtë gjeni, specifikimet teknike për secilin modul që duhet shtuar në kuadër të përgjegjësisë të reja që rrjedhin për IKRTK në zbatim të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.**

### **I. KATALOGU I FONDIT MUZEOR KOMBËTAR**

Operatori Ekonomik do të mundesoje shtimin e një moduli i cili do të reflektojë Katalogun e Fondit Muzeor Kombëtar, dhe për këtë qëllim detajohet me hollësi si më poshtë vijon:

Në zbatim të Neneve 32, 215, 221 dhe 222 të Ligjit 27/2018, Objektet dhe koleksionet e Fondit Muzeor Kombëtar përfshihen në **Katalogun e Fondit Muzeor Kombëtar** - një bazë të dhënash, që përmban informacionin bazë në lidhje me objektet dhe koleksionet muzeore, katalog, i cili mbahet dhe përditësohet nga IKRTK.

Dokumentacioni për krijimin e një muzeu, ndër të tjera, duhet të provojë: ekzistencën e objekteve muzeore, koleksioneve të shoqëruara me dokumentacionet përkatëse të lëshuara nga IKRTK.

Fondet e pasurive kulturore të luajtshme, në kuptim të këtij ligji, që janë fonde muzeore të muzeve të akredituar, përbëjnë Fondin Muzeor Kombëtar, i cili mbrohet nga shteti, sipas parashikimeve të këtij ligji. Fondi Muzeor Kombëtar formohet nga tërësia e koleksioneve të muzeve të akredituar qendrorë e vendorë dhe atyre autonomë e privatë. Objektet dhe koleksionet e Fondit Muzeor Kombëtar përfshihen në Katalogun e Fondit Muzeor Kombëtar. Këshilli Kombëtar i Muzeve përcakton rregullat dhe procedurat për krijimin, plotësimin, përditësimin e Katalogut të Fondit Muzeor Kombëtar. Me propozimin e përbashkët të IKRTK-së e IKTK-së dhe miratimin e KKM-së hartohen masat për ruajtjen, mbrojtjen, mirëmbajtjen, administrimin, tjetërsimin dhe qarkullimin e objekteve muzeore e të koleksioneve muzeore. Për sa më sipër është i nevojshëm digjitalizimi i regjistrave të Fondeve Muzeore.

### **Procesi i Dixhitalizimit i regjistrave të Fondeve Muzeore si dhe krijimin, plotësimin, përditësimin e Katalogut të Fondit Muzeor Kombëtar.**

Operatori ekonomik fitues gjatë procesit të dixhitalizimit (skanimit dhe indeksimit) duhet të përdori të gjitha pajisjet e tij, të nevojshme për realizimin e këtij shërbimi dhe dorëzimi të produktit në format elektronik. Për këtë ai duhet të disponojë pajisje skanimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

profesionale (Skanera Librash/Regjistrash) me shpejtësi të mjaftueshme që garanton realizimin e shërbimit me punë të pa ndërprerë Operatori ekonomik fitues duhet të beje:

1. Perpunimin e dokumentave dhe klasifikimin e tyre sipas kategorive perkatese.
2. Skanimin, indeksimin e dokumentacionit sipas kategorizimit përkatës të dakortësuar me specialistet e IKRTK.
3. Dorezimin e katalogut ne format elektronik ne nje nga serverat e institucionit.

Për realizimin e këtij procesi do të zhvillohen aktivitetet e mëposhtme:

- Ngritja dhe vendosja në dispozicion e infrastrukturës teknologjike (hardware dhe software) për realizimin e objektivave të këtij procesi;
- Konfigurimi dhe testimi i funksionalitetit te regjistrave të Fondeve Muzeore ne foto;
- Trajnimi i grupeve te vleresimit mbi proceduren perkatese
- Ndjekja e procedurave mbi krijimin dhe plotësimin e Katalogut per cdo rregjister të Fondit Muzeor Kombëtar.
- Migrimi dhe optimizimi informacionit që tashmë është digjitalizuar;
- Përsëritja e vleresimit/fotografimit të strukturave të cilat nuk janë vlerësuar për arsye të ndryshme gjatë procesit;
- Kontraktori duhet të paraqesë një plan të detajuar të të gjitha proceseve që do të kryhen për realizimin e projektit, në këtë plan duhet të përfshihen:
  - Furnizim, delivrim dhe instalimi i paisjeve HW ;
  - Furnizim, instalim dhe konfigurim i sistemit aplikativ, i cili do te menaxhoje katalogun e regjistrave të Fondeve Muzeore.
  - Përgatitja e dokumentave për vlersim/fotografim tamplate;
  - Skanimi/fotografimi i regjistrave të Fondeve Muzeore;
  - Përsëritja e Skanimit/fotografimit të dokumenteve të pa lexueshme/ harruar;
  - Indeksi i imazheve të skanuara/fotografuara, sipas informacionit te vlerësuar dhe te kerkuar;
  - Ngarkimi i imazheve të digjitalizuar dhe indekseve në bazën qendrore të të dhënave;
- Shërbimet dhe lehtësirat që ofron autoriteti kontraktor. Autoriteti kontraktor do të mundësojë:
  - i. Akses të kontrolluar në institucion;
  - ii. Hapësirë zyre të përshtatshme brenda institucionit për stafin e kontraktorit që të aksesojë dhe konfigurojë aplikacionin, pajisjet ndihmese, dokumentat, regjistrat etj.
  - iii. Identifikimin e një anëtar stafi, që do të jetë përgjegjës për problemet e koordinimit dhe bashkëpunimit të përditshme me Kontraktorin;





## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

iv. Mbikëqyrjen, monitorimin dhe testimin e pranimit të dorëzimeve përfundimtare të Kontraktorit me asistencë të titullarit.

Operatori ekonomik fitues duhet të jetë konfidencial me dokumentet që do të skanojë dhe indeksojë duke mos i keqpërdorur, kopjuar, etj. Para procesit të punës punonjësit do të firmosin një dokument për ruajtjen e konfidencialitetit. Për këtë procedurë, për të lehtësuar procesin e punës, skanimet e dokumenteve të arkives së kontrollit do të bëhen në ambientet e dedikuara të AK në Tiranë. AK duhet të sigurojë ambiente të përshtatetshme për trajtimin e dokumentave, me të gjitha masat e mbrojtjes e sigurisë si dhe të përshtatetshme për teknologjinë e përdorur në mënyrë që të garantohet siguria dhe mos demtimi i materialeve.

OE fitues duhet të realizojë të gjithë punën me pajisjet e tij sipas kërkesave të AK.

Para dorëzimit përfundimtar të dokumentacionit dixhital, do të bëhet një kontroll i cilësisë së dokumentacionit dixhital. Fillimisht duhet të kontrollohen nëse meta-datat e regjistruara të materialeve përputhen me të dhënat e materialeve origjinale. Nëse jo, bëhet korrigjimi i tyre.

Pastaj kontrollohet cilësia e imazheve. Imazhet duhet të jenë lexueshme nga syri i njeriut, kështu që duhet të kenë dritë dhe kontrast në nivelin e duhur. Nëse ka nevojë do të bëhen korrigjimet e imazhit si rregullimi i kontrastit, rrotullimi i tij, korrigjimi i dritës etj. Në rastet kur imazhi është i demtuar (i ndryshëm nga origjinali) dhe funksionet për rregullimin e imazhit nuk mundet ta korrigjojnë në një imazh të sigurt, ai dokumentacion rikthehet për tu riskuar.

Pasi kontrolli i cilësisë të kalojë me sukses, të materialet e skanuara dhe indeksuara do të transferohen në një sistem kompjuterik të AK.

## **II. REGJISTRI KOMBËTAR I LICENCAVE TË EKSPORT/IMPORTIT TË PASURIVE KULTURORE**

Operatori Ekonomik do të mundësojë krijimin e regjistrimit kombëtar të licencave të eksport/importit të pasurive kulturore. Për këtë proces Operatori Ekonomik duhet të ketë njohuri shumë të mira mbi proceset që realizohen dhe të detajuara si më poshtë:

Procedura e lëshimit të licencave të eksport/importit të pasurive kulturore, është një risi për monitorimin e procedurave të eksportit për qarkullimin kombëtar e ndërkombëtar, të certifikuar, të pasurive kulturore të luajtshme si dhe një procedurë e re për institucionet që merren me zbatim e saj, lëshimi i licencave të eksport/importit të pasurive kulturore sipas Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” është konform me legjislacionin e BE-s, referuar këtu tre rregulloret kryesore për mënyrat e qarkullimit të pasurive kulturore, “Council Regulation (EC) No 116/2009 of 18 December 2008 on the export of



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

cultural goods”, “Regulation (EU) No **1081/2012** of 9 November 2012 for the purposes of Council Regulation (EC) No 116/2009 on the export of cultural goods”, si dhe rregullores për importin e pasurive kulturore e cila ende nuk është vënë plotësisht në zbatim nga vendet e BE, rregullore nr. **2019/880**.

Procedurat e lëshimit të licencave të export/importit të pasurive kulturore do të kryhen nga IKRTK-së, referuar këtu edhe standardeve të BE-s, për përcaktimin e një organi kompetent për zbatimin dhe monitorimin e eksportit për qarkullimin ndërkombëtar, të certifikuar, të pasurive kulturore të luajtshme, si dhe pranë IKRTK-s krijohen dhe funksionojnë zyrat rajonale dhe zyrat e eksportit të pasurive kulturore të luajtshme, në përputhje me parashikimet e Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” për:

a) regjistrimin on-line të pasurive kulturore kombëtare dhe çdo procedure për identifikim dhe regjistrim;

b) zbatimin dhe monitorimin e procedurave të eksportit për qarkullimin kombëtar e ndërkombëtar, të certifikuar, të pasurive kulturore të luajtshme, në bashkëpunim me institucionet doganore dhe Policinë e Shtetit.

Për sa më lart, lëshimi i licencave të export/importit të pasurive kulturore, formalizon dhe standardizon rregullat e sistemit tonë doganor me ato të BE-s, lidhur me qarkullimin e lirë të pasurive kulturore.

- Hyrja e pasurive kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë, të parashikuara në pikën 3, të nenit 123, të ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, lejohet kundrejt lëshimit, paraprakisht, të **licencës së importit** nga zyra kompetente për çështjet e eksportit, me kërkesë të subjektit të interesuar.
- Eksporti i pasurive të luajtshme kulturore nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt vendeve të tjera kryhet pas pajisjes me **licencë të qarkullimit të lirë**, në përputhje me parashikimet e ligjit 27/2018 dhe me parashikimet ndërkombëtare të fushës. Subjekti, i cili kërkon të nxjerrë pa kthim nga territori i Republikës së Shqipërisë pasuritë e përcaktuara në pikën 3, të nenit 123, të ligjit 27/2018, pajiset me licencën e qarkullimit të lirë, duke deklaruar në zyrën për çështjet e eksportit pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.
- Eksporti i pasurive të luajtshme kulturore nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt vendeve të tjera kryhet pas pajisjes me licencë të qarkullimit të përkohshëm, në përputhje me parashikimet e ligjit 27/2018 dhe me parashikimet ndërkombëtare të fushës. Subjekti, i cili kërkon të nxjerrë me të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

drejtë kthimi nga territori i Republikës së Shqipërisë pasuritë e përcaktuara në nenin 124, të ligjit 27/2018, pajiset me licencën e qarkullimit të përkohshëm, duke deklaruar në zyrën për çështjet e eksportit pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

Per sa më sipër, Operatori Ekonomik do të mundesoje shërbimin e mirembajtjes dhe permiresimin e regjistrit kombëtar të licencave të eksport/importit të pasurive kulturore.

**III. REGJISTRI I TREGTIMIT TË PASURIVE KULTURORE**

Veprimtaria tregtare e pasurive kulturore ushtrohet nga subjektet tregtare të licencuara në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet.

1. Licenca për tregti në pasuri kulturore është akti administrativ, i cili i njeh mbajtësit të saj, personit fizik/personit juridik, të drejtën për të filluar dhe ushtruar llojin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.
2. Për qëllim të kësaj Licence, tregtimi i pasurisë kulturore është ushtrimi i veprimtarive legjitime të:
  - a) shitjes për publikun;
  - b) ekspozitës për qëllime tregtare, dhe;
  - c) ndërmjetësimit me qëllim të shitjes,

të çdo pasurie kulturore materiale që mund të përfshihet në kategoritë e nenit 50 dhe të nenit 51, pika 1, germa b) të Ligjit 27/2018 për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë dhe vetëm në rastet kur prona e tillë mund të tregtohet në mënyrë të ligjshme në Shqipëri.

◆ **Dokumentet shoqëruese për marrjen e licencës për një person fizik**

1. Për një person fizik i cili i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë vendim për marrjen e licencës për herë të parë, Aplikimi do të shoqërohet nga:
  - a) Formulari i Aplikimit për marrjen e licencës, sipas modelit bashkëlidhur këtij Vendimi;
  - b) Certifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (numri i NIPT-it);
  - c) Kopja e ID-së e aplikantit;
  - a) Vetë-deklarimi i aplikantit si person fizik se ai/ajo nuk ka qenë i dënuar penalisht ose nuk është objekt i ndjekjes penale;
  - g) Dëshmia e pagesës së tarifës përkatëse për aplikim siç përcaktohet në këtë vendim.

◆ **Dokumentet shoqëruese për marrjen e licencës për personin juridik**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

1. Për një person juridik që i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë vendim për marrjen e licencës për herë të parë, aplikimi shoqërohet nga:
  - a) Formulari i Aplikimit për marrjen e licencës, sipas modelit bashkëlidhur këtij Vendimi;
  - b) Certifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (numri i NIPT) dhe Ekstrakti i përditësuar i Historikut nga Regjistri Tregtar;
  - c) Kopja e ID-së e përfaqësuesit ligjor të personit juridik;
  - b) Vetë-deklarimi i përfaqësuesit ligjor të aplikantit si person juridik se vetë personi juridik, ose anëtarët e organit drejtues, aksionari (aksionarët) ose ortaku (ortakët), kompanitë mëmë, ose subjektet kontrolluese aktuale dhe përfaqësuesi(t) ligjor(ë) të tyre, nuk janë dënuar penalisht ose nuk janë objekt i një ndjekje penale;
  - g) Prova e pagesës së tarifës përkatëse të aplikimit siç përcaktohet në këtë vendim.

◆ **Dokumentet shoqëruese për licencën zëvendësuese në rast të humbjes ose dëmtimit të asaj ekzistuese**

1. Aplikimi i mbajtësit të licencës për të marrë një zëvendësim të licencës në rast të humbjes ose dëmtimit të asaj ekzistuese, shoqërohet me formularin e aplikimit, sipas modelit të bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Në rastin kur aplikimi ka të bëjë me zëvendësimin e licencës së dëmtuar për të marrë një licencë të re, mbajtësi i licencës duhet ta dorëzojë atë të dëmtuarën.
3. Licenca e dëmtuar/e humbur do të deklarohet e pavlefshme dhe do të lëshohet një e re, me të njëjtat të dhëna dhe një datë të re të lëshimit.

◆ **Dorëzimi dhe pranimi i Aplikimeve**

1. Aplikimi për licencë, si dhe dokumentet që e shoqërojnë atë, dërgohen përmes sistemit të integruar të informacionit për licencimin e veprimtarive tregtare në pasuri kulturore, i cili funksionon në kuadër të portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania.
2. Dokumentet që duhet të paraqiten për të marrë licencën, siç renditet në Seksionin IV, A të këtij Vendimi, do të ngarkohen (futen) në sistem, në format e mëposhtme:
  - a) origjinale ose të vërtetuara nga origjinali;
  - b) në Shqip, ose të përkthyer në Shqip nga përkthyes zyrtarë dhe të vërtetuara me origjinalin;
  - c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopjet e vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter). Ekziston detyrimi për të provuar ekzistencën e tyre si zyrtarë ose noterë, përmes legalizimit ose vulës apostile, në përputhje me ligjet në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

3. Paguesa e tarifës për marrjen e një licence bëhet përmes sistemit të integruar të informacionit për shërbimet e licencimit për aktivitete ndërhyrëse në pasuri të prekshme kulturore, i cili funksionon në kuadër të portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania, në ‘one-stop-shop’ në hapësirën e aplikantit ose në ndonjë bankë të nivelit të dytë, përmes formularit të faturës pranuese.
4. Dorëzimi fizik i një ose disa dokumenteve në ‘one-stop shop’ do të kryhet vetëm në rastet vijuese:
  - a) për paraqitjen e licencës së mëparshme në rastet e parashikuara në këtë vendim;
  - b) kur kërkohet verifikimi i dokumentit/dokumenteve nga Sekretariati i IKRPK-së.

◆ **Shqyrtimi i aplikimeve për licencim**

1. Aplikimet për licencim dhe për revokimin e një licence të dhënë do të menaxhohen nga ‘One Stop Shop’ dhe Sekretariati i IKRTK-së.
2. Vendimi për dhënien e licencës merret nga Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore me propozim të IKRTK-së.
3. Licenca e kërkuar do të jepet pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve për licencë të parashikuara nga Ligji Nr. 27/2018 për “Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” dhe ky Vendim. Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore merr vendim në lidhje me aplikimin për licencë brenda 20 ditësh pune nga regjistrimi i aplikimit. Skadimi i këtij afati pa i dhënë një përgjigje subjektit që ka kërkuar licencën do të konsiderohet si një miratim i licencës sipas parimit të pëlqimit të heshtur.
4. Një ankesë kundër një vendimit që refuzon dhënien e licencës mund të bëhet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative, brenda 45 ditëve nga njoftimi, sipas ligjit, i vendimit për refuzimin e aplikimit për licencë.
5. IKRTK-ja ua dorëzon licencën origjinale palëve të interesuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga hyrja në fuqi e urdhrit të tij, përmes shërbimit postar ose ato merren nga vetë personi i licencuar ose nga persona të autorizuar me akt noterial për të kryer një veprim të tillë, ose nga persona të autorizuar nga personi juridik. Një kopje e autorizimit do të depozitohet në dosjen e arkivuar. Licenca do të ngarkohet (fute) gjithashtu në platformën e internetit E-Albania, nga ku aplikanti mund të shkarkojë një kopje të saj të nënshkruar në mënyrë elektronike në çdo kohë.
6. Miratimi i një licence për tregti në pasuri kulturore, dhënia e një licence zëvendësuese në rast të humbjes ose dëmtimit të asaj ekzistuese, si dhe çdo vendim për revokimin e licencës do të regjistrohen në Regjistrin e Licencave për Tregti me Pronën Kulturore i cili administrohet nga IKRTK-ja, si dhe në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

### **IV. CERTIFIKATA E PASURISË KULTURORE**

Operatori ekonomik do të realizojë përmirësimin e modulit ekzistues të Certifikatës së Pasurisë Kulturore. Në zbatim të Neni 70, të Ligjit 27/2018, pas kryerjes së procedurave të identifikimit, Inventarizimit, vlerësimit dhe regjistrimit IKRTK lëshon Certifikatën e Pasurisë Kulturore. Certifikata e pasurisë kulturore lëshohet nga IKRTK-ja në bazë të urdhrit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore të deklaramit të objektit pasuri kulturore.

Certifikata e pasurisë kulturore duhet të përmbajë, minimalisht, informacionin e nevojshëm mbi këto elemente identifikimi:

- a. fotografi ose imazh tjetër të pasurisë;
- b. Informacion mbi koordinatat, tipin, masën dhe peshën, materialin e teknikën e prodhimit/krijimit, si dhe shenja të veçanta;
- c. Emrin e autorit/krijuesit, nëse është i njohur;
- d. datën dhe vendin e zbulimit/krijimit;
- e. përshkrim të shkurtër;
- f. udhëzime mbi ruajtjen dhe parashikimet ligjore përkatëse;
- g. zonën e mbrojtur të pasurisë kulturore të paluajtshme.

Sipas procedurave aktuale Certifikata e pasurisë kulturore lëshohet në 1 kopje, si për pasuritë e veçanta, ashtu edhe për koleksionet, dhe në rast humbjeje të saj IKRTK-ja lëshon dublikatë të saj.

Operatori ekonomik do të mundësojë përmirësimin e modulit ekzistues të Certifikatës së Pasurisë Kulturore në sistem si dhe çdo element të saj të saktësuar nga përfaqësuesit e IKRTK.

### **V. VERIFIKIMI DHE DEKLARIMI I INTERESIT KULTUROR**

Operatori ekonomik do të realizojë shtimin e një moduli të ri në sistemin ekzistues, i cili do të realizojë verifikimin dhe deklarinë e interesit. Në zbatim të Neneve 57, 58, 59, 60, 61, të Seksionit I – Verifikimi, i Kreut II - Verifikimi dhe deklarami i interesit kulturor dhe regjistrimi i pasurisë kulturore, të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”. Kërkesa për verifikim paraqitet nga subjektet publike ose private pranë IKRTK-së, për pasuritë e luajtshme, brenda një afati 120-ditor, nga marrja e kërkesës, del, me vendim të titullarit, konstatimin ose jo të interesit kulturor të pasurisë objekt verifikimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

Operatori ekonomik në modulën e krijuar do të mundësojë regjistrimin e të gjithë kërkesave dhe krijimet përkatëse me fushat e përcaktuara:

- **Kodi i objektit:** Kodi i objektit është unik dhe identifikon objektin.
- **Objekt** – çdo objekt do të mbajë të gjitha të dhënat si:
  - (KODI, TITULLI, FUSHA (fusha që i përket objekti),
  - KATEGORIA (Kategoria e objekti),
  - TIPI,
  - MATERIALI,
  - TEKNIKA,
  - KULTURA,
  - AUTORI,
  - PERIUDHA,
  - VITI,
  - PERMASA,
  - PESHA,
  - AUTENTICITETI,
  - POSEDUESI,
  - NR.REGJISTRI,
  - STATUSI,
  - VLEFTA,
  - VEND ORIGJINA,
  - STATUSII AKTIVITETIT,
  - SKEDUESI,
  - DT.SKEDIMIT,
  - LEVIZJA E OBJEKTIT,
  - HISTORIK,
  - PËRSHKRIM,
  - BIBLIOGRAFI,
  - RESTAURIME,
  - TE TJERA, FOTO, VIDEO, DOC,)

**Galeria-** Të gjithë skedarët si foto, video, doc, pdf që i përkasin objektit.

Operatori ekonomik në modulën e krijuar do të mundësojë gjenerimin e raporteve sipas të gjitha fushave të sipër përmendura, si dhe të gjenerohet vërtetimi sipas formatit aktual.

**VI. REGJISTRI KOMBËTAR I PASURIVE KULTURORE TË VJEDHURA**



## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Operatori ekonomik do të realizojë shtimin e një moduli të ri në sistemin ekzisues, shtimin e regjistrimit kombëtar të pasurive kulturore të vjedhura. Baza e të dhënave mbledh të dhëna në lidhje me pasuritë kulturore të luajtshme, të mbrojtura sipas neneve 50 dhe 51 të ligjit, të vjedhura dhe të kontrabanduara, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, nga Shteti, Rajonet (qarqet), organet e tjera publike territoriale (bashkitë), si dhe nga çdo organ dhe institucion tjetër publik si dhe personat juridikë jofitimprurës privatë, përfshirë organet ekleziastike (kishtare) të njohura civilisht me qëllim lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve në parandalimin dhe luftën e veprave penale dhe veprave të tjera kundër trashëgimisë kulturore.

Në të njëjtën Bazë të të dhënave mbledhen edhe të dhëna që kanë të bëjnë me pasuritë e luajtshme të vjedhura dhe kontrabanduara brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë nga subjekte tjera nga ato të përmendura më lart, me kusht që ato të mund të njihen si pasuri kulturore, në përputhje me nenet 50 dhe 51 të Ligjit, me qëllim parandalimin dhe luftën ndaj krimeve kundër trashëgimisë kulturore. Zyra e Çështjeve të Eksportit të IKRTK ka akses në Bazën e të Dhënave ekskluzivisht për pjesën që lidhet me pamjet dhe përshkrimet e pasurive kulturore të vjedhura që janë kompjuterizuar aty brenda, me qëllim parandalimin dhe luftën kundër qarkullimit të tyre të paligjshëm.

Baza e të Dhënave duhet organizuar në mënyrë të tillë që të mundësojë IKRTK-në, në lidhje me qëllimet e përmendura, të kryejë përpunimin statistikor, hulumtimin, studimet dhe analizën e të dhënave, si dhe mundësinë e komunikimit ose shpërndarjes së tyre, vetëm në formë anonime dhe të agreguar në mënyrë të tillë që personat në fjalë të mos mund të identifikohen. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoritë Vendore të Policisë, pranë të cilave funksionon shërbimet e policisë gjyqësore, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Zyrat e Degëve Doganore, dhe çdo institucion tjetër ligjzbatues, janë të detyruar të japin informacion tek Baza e të Dhënave në mënyrat dhe afatet e treguara më poshtë, nga momenti i marrjes dijeni për krime në lidhje me vjedhjen e pasurisë dhe deri në rikuperimin e saj, përfshirë pasuritë që i përkasin vetëm institucioneve publike, të cilat nuk janë kthyer nga eksporti i përkohshëm i ligjshëm.

### **VI.I Dhënësit e Informacionit**

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoritë Vendore të Policisë, pranë të cilave funksionon shërbimet e policisë gjyqësore, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Zyrat e Degëve Doganore, dhe çdo institucion tjetër ligjzbatues, janë të detyruar të japin informacion tek Baza e të Dhënave në mënyrat dhe afatet e treguara më poshtë, nga momenti i marrjes në dijeni për krime në lidhje me vjedhjen e pasurisë dhe deri në rikuperimin e saj, përfshirë pasuritë që i përkasin vetëm institucioneve publike, të cilat nuk janë kthyer nga eksporti i përkohshëm i ligjshëm.





## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

### VI.II Të dhënat që duhet të komunikohen:

- a) raportimi i ngjarjes ose raporti (Protokolli i Zyrës së Procedimit; Referenca e policisë në Bazën e të Dhënave Policore; Data e Raportit; kallëzuesi; Lloji i krimit të kallëzuar)
- b) të dhënat për ngjarjen ku ka ndodhur vjedhja e mallit ose eksporti i paligjshëm (Data e Ngjarjes; Vendi në të cilin është kryer krimi; Modus Operandi);
- c) të mallrave që i nënshtrohen largimit apo eksportit të paligjshëm (përshkrimi teknik; përshkrimi të lirë dhe çdo element për identifikimin e objektit; Kodin e Katalogut të IKRTK-së ; numrin e referencës së licencës së qarkullimit të lirë; riprodhimin fotografik);
- d) të dëmtimit të pasurisë së luajtshme (vlerësimi Ekonomik);
- e) të mbulimit të sigurimit (Pasuria e Siguruar; Vera e Siguruar).

### VI.III Si është e organizuar baza e të dhënave dhe funksionet e saj

Procesi i menaxhimit të Bazës së të Dhënave është i ndarë në fazat dhe aktivitetet e mëposhtme:

- i. marrja e komunikimeve;
  - ii. verifikimin e përmbajtjes së komunikimeve në lidhje me qëllimet e përmendura më lart;
  - iii. hedhja e të dhënave pas konfirmimit;
  - iv. komunikimi që të dhënat nuk gjenden të jenë në përputhje me qëllimet e parashikuara;
  - v. konsultimi nga subjektet e autorizuara.
- Pas marrjes së të dhënave, IKRTK-ja kontrollon nëse të dhënat janë komunikuar në mënyrën e parashikuar nga Vendimi dhe se ato përputhen me qëllimet e parashikuara.
  - Nëse të dhënat e transmetuara nuk e kalojnë verifikimin e përmendur në pikën 2, IKRTK -ja informon Zyrën e Komunikimit në mënyrë që kjo e fundit të mund të korrigjojë mangësitë teknike dhe përshkruese, kur është e mundur, brenda njëzet ditëve nga marrja e kërkesës.
  - Të dhënat regjistrohen në Bazën e të Dhënave deri në rikuperimin e pasurisë kulturore ose datën e procedurës ligjore ose administrative, në zbatim të ligjit nr.9988, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
  - IKRTK -ja mund të shpërndajë të dhënat për qëllime statistikore dhe në formë të agreguar për qëllime studimi dhe të parandalimit të krimeve, me teknika që



## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

nuk lejojnë që palët e interesuara të identifikohen, as edhe në mënyrë indirekte.

- Si pjesë e masave më të gjëra të sigurisë të miratuara në bazë të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", veprimet e kryera në bazën e të dhënave regjistrohen dhe ruhen nga IKRTK-ja duke përdorur kodin e identifikimit të personit përgjegjës i cili e ka kryer operacionin, datën dhe kohën e aksesit, kodet e përdorura për kërkim, numrin e skedarit dhe të dhënat e konsultuara.

### VI.IV Konsultimi i Bazës së të Dhënave

- Organet Gjyqësore, Policia e Shtetit, Dogana dhe Drejtoritë Vendore të Policisë, mund të kërkojnë që ato pajisen me informacione që mund të shkarkohen nga Baza e të Dhënave, duke i bërë kërkesë personelit të specializuar të IKRTK-së, të ngarkuar me përpunimin e të dhënave personale dhe të autorizuar posaçërisht për këto funksione.
- Organet e administratës publike, të cilat janë përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe parandalimin dhe luftën ndaj krimeve kundër trashëgimisë kulturore, mund të kërkojnë informacion nga IKRTK-ja, të kufizuara tek të dhëna jo personale të përfshira në Bazën e të Dhënave.
- Tregtarët e pasurive kulturore dhe personat privatë gjithashtu mund të kërkojnë të verifikojnë në Bazën e të Dhënave origjinën e ligjshme të një pasurie kulturore, për sa kohë ata janë në gjendje të ofrojnë informacionin e nevojshëm për identifikimin e pasurisë që do të kontrollohet, me anë të një kërkesë që i drejtohet Drejtorit të IKRTK -së.
- Si pjesë e masave më të gjëra të sigurisë të miratuara në bazë të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", veprimet e kryera në bazën e të dhënave regjistrohen dhe ruhen nga IKRTK-ja duke përdorur kodin e identifikimit të personit përgjegjës i cili e ka kryer operacionin, datën dhe kohën e aksesit, kodet e përdorura për kërkim, numrin e skedarit dhe të dhënat e konsultuara.
- Kreu IKRTK-së, kryen verifikime të veprimeve të kryera nga palët e autorizuar, përmes kontrolleve periodike ose atyre rastësore.
- Pa cenuar përgjegjësinë personale për veprime të paligjshme të kryera në Bazën e të Dhënave, Kreu IKRTK-së pezullon aksesit personit që ka vepruar në mënyrë të paligjshme ose i cili ka shkelur në mënyrë të përsëritur udhëzimet dhe procedurat e përcaktuara në Shtojcën "D", e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.



## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

### VI.V Udhëzime të hollësishme për menaxhimin e bazës së të dhënave të pasurisë kulturore të vjedhura

Baza e të Dhënave të Pasurive Kulturore të Vjedhura menagjohet nga **Ministria e Kulturës**, nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të **Drejtorit të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore**, i cili, përmes zyrës së tij, kujdeset për furnizimin dhe përditësimin e saktë me të dhëna, si dhe zhvillimin e sistemit kompjuterik, në përputhje me standardet ndërkombëtare, edhe për të siguruar një rrjedhë adekuate të informacionit me Bazën e të Dhënave të Veprave të Vjedhura të Artit të INTERPOL-it.

Baza e të Dhënave e Pasurisë Kulturore të Vjedhura është e ndarë në zona tematike të ndryshme, për shkak të funksioneve të ndryshme që ajo kryen, të cilat korrespondojnë me të njëjtin numër detyrash që kryhen nga personeli përgjegjës për hedhjen dhe konsultimin e të dhënave me qëllim verifikimin e pasurisë (qoftë ajo e vjedhur apo jo):

- a) **"Hedhja e të dhënave"**: kushtuar gjenerimit të "ngjarjes", të lidhur me pasurinë kulturore me të cilën lidhet emri i pronarit/pronarëve të ligjshëm;
- b) **"Kërkim / Konsultim"**: kushtuar kërkimit të të dhënave të pranishme, si dhe krahasimit të imazheve të pasurisë kulturore që analizohet me ato që duhen verifikuar mbi bazën e raporteve nga institucionet publike (Policia, Doganat, Mbikëqyrja), etj) ose ato të paraqitura nga persona privatë duke plotësuar formularin e kërkesës;
- c) **"Statistika"**: kushtuar analizës së ngjarjeve të zhvilluara, referuar në pikën a), të ndara sipas periudhës kohore (p.sh. krahasimi sipas vitit/muajit) dhe referuar të gjithë territorit kombëtar ose sipas zonës gjeografike (Qarku, Bashkia);
- d) **"Administrimi"**: kushtuar menaxhimit të sistemit të informacionit të Bazës së të Dhënave.

Në fushën tematike **"Hedhja e të Dhënave"** duhet të hidhni informacionin në lidhje me furnizimin/përditësimin e të dhënave për ngjarjet në lidhje me:

- a. **pasurinë kulturore**, të përcaktuar në nenet 50 dhe 51 të ligjit 27, datë 17.05.2018, për t'u kontrolluar (furnizimi me të dhëna);
- b. **refuzimet për lëshim e licencës për qarkullim të lirë**, në përputhje me nenin 125 i Ligjit 27/2018 (furnizimi me të dhëna);
- c. **rikuperimi/vendndodhja /sekuestrimit i pasurisë kulturore**, sipas pikës a), të vjedhura në rast të zbulimit të tyre të mëvonshëm (përditësim i të dhënave), fakte të tjera si p.sh.:
  - **zbulime të gërmimeve të paligjshme;**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

- **dëmtimi i pasurive kulturore të paluajtshme** (monumente, ndërtesat historike), qoftë nga njeriu ose si rezultat i fatkeqësive natyrore;
- d. **Gjenerimi dhe përditësimi i personave dhe vendeve** në lidhje me ngjarjen (përfshirja e të cilave është thelbësore për krijimin e ngjarjes).

Pasi të jetë marrë raportimi/dhënia e informacioni për pasurinë kulturore të vjedhur/kontrabanduara, **operatori i Bazës së të Dhënave:**

a) Kontrollon si fillim nëse pasuria kulturore mund të kërkohet dhe më pas konstaton nëse ngjarja gjendet tashmë në Bazën e të Dhënave, dhe nëse jo, krijohet/një "ngjarje e re". "Ngjarja e re" përmban të dhënat e mëposhtme:

- **Llojin e krimit të kryer** (vjedhje, plaçkitje, mashtrim, përvetësim, eksport i paligjshëm, etj.) Ose nëse është një pasuri kulturore e humbur (p.sh. si rezultat i inventarit);
- **Periudha kohore** (data e fillimit dhe data e mbarimit, nëse dihet) e kryerjes së veprës penale ose e humbjes së pasurisë kulturore;
- **Raporti përkatës/ të dhënat e raportit:**
  - Zyra e Raportimit (Muzeu, Mbikëqyrja, Policia, Doganat);
  - Data e dorëzimit;
  - Protokollin e kompjuterit (nëse Raporti është futur në Bazën e të Dhënave të Policisë së Shtetit);
- **Vendndodhja e ngjarjeve**, Muze, galeri arti, dyqan antik, shtëpi private, vend fetar, etj .;
- **Personi fizik** i konfiguruar zakonisht si Ankuesi: kontrolloni nëse personi është apo jo i regjistruar në Bazën e të Dhënave, dhe nëse jo, krijohet një "person i ri fizik" duke futur mbiemrin, emrin, vendin dhe datën e lindjes, adresën e vendbanimit dhe kontaktet personale;
- **Dokumentet:** merrni komunikimin/raportimin e Zyrës Raportuese në formatin pdf dhe hidheni atë në sistemin e informacionit;
- **Pasuri kulturore**, për një kompjuterizim të saktë, duhet të shfaqen parametrat e mëposhtëm:
  - *Sasia* (në përgjithësi korrespondon me 1 sepse duhet të hidhni vetëm një pasuri kulturore çdo herë);
  - *Konteksti i veprës së artit* (Paleontologjik, arkeologjik, antik, modern, bashkëkohor);
  - *Lloji i objektit* (Pikturë, grafikë, skulpturë, gjetje arkeologjike, libër/dokument arkivash, mobilie të veçanta, etj.) dhe Subjekti (specifikoni tipologjinë e saktë të objektit/subjektit të përfaqësuar nga prona kulturore);
  - *Materiali* (letër, dru, kanavacë, lloj metali, qelq, gur, pëlhurë, etj.);



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

- *Teknika e punimit* (vaj, tempera, pastel, mozaik, serigrafji, litografi, media e përzier, relief i lartë, relief i ulët, punim me gur, dekorim, gdhendje metali, stampimi, punim me gdhendje, zbukurim, etj.);
  - *Matjet* (*Lartësia, gjerësia, thellësia dhe diametri në cm; pesha në kg*);
  - *Formati* ;
  - *Autori* (*nëse dihet shkruaj "nënshkruar nga ...", ose "i atribuohet ...", ose "Shkolla e ...", koha e ekzekutimit – shënimi shekullin dhe, nëse dihet, vitin*);
  - *Titulli i veprës së artit*;
  - *Përshkrimi përmbledhës i pasurisë kulturore*;
  - *Fotografi*;
  - *Informacione të tjera* (*katalogimi/numri i inventarit, vlera, e mbuluar nga sigurimi, referenca në Bazën e të Dhënave të INTERPOL, publikimi i mundshëm në një faqe interneti të jashtme të hapur për publikun, etj.*).
- b) Regjistroni refuzimin për lëshimin e licencës së qarkullimit të lirë, në përputhje me nenin 125 të Ligjit 27/2018 (furnizimi) që gjeneron një "ngjarje të re". "Ngjarja e re" do të përmbajë të dhënat e mëposhtme:
- **Numrin e protokollit, datën e lëshimit dhe zyrë** që ka lëshuar refuzimin;
  - **Datën e paraqitjes** (dhe numrin e protokollit të mbërritjes, nëse ka) të kërkesës për licencën e qarkullimit të lirë;
  - **Datën e revokimit të refuzimit/** numri i protokollit, nëse ka, dhe Zyrën që ka revokuar Vendimin;
  - **Vendin e ngjarjes** (korrespondon me vendin ku ndodhet pasuria kulturore në kohën e paraqitjes së kërkesës);
  - **Personi fizik** (i konfiguruar zakonisht me paraqitësin e kërkesës/pronarin ose me ndonjë ndërmjetës: verifikoni nëse personi është i regjistruar apo jo në Bazën e të Dhënave, dhe nëse jo, krijohet një "person fizik i ri fizik" duke hedhur emrin, mbiemrin, vendin dhe datën e lindjes, adresën e vendbanimit dhe kontaktet personale;
  - **Dokumentet: merrni komunikimin/raportimin e Zyrës Raportuese në formatin pdf dhe hidhni atë në sistemin e informacionit**;
  - **Pasuria Kulturore, për kompjuterizimin e saktë, duhet të tregohen parametrat e mëposhtëm:**
    - *Sasia* (në përgjithësi korrespondon me 1 sepse duhet të hidhni vetëm një pasuri kulturore çdo herë);
    - *Konteksti i veprës së artit* (Paleontologjik, arkeologjik, antik, modern, bashkëkohor);
    - *Lloji i objektit* (Pikturë, grafikë, skulpturë, gjetje arkeologjike, libër/dokument arkivash, mobilie të veçanta, etj.) dhe Subjekti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

(specifikoni tipologjinë e saktë të objektit/subjektit të përfaqësuar nga prona kulturore);

- *Materiali* (letër, dru, kanavacë, lloj metali, qelq, gur, pëlhurë, etj.);
- *Teknika e punimit* (vaj, tempera, pastel, mozaik, serigrafji, litografi, media e përzier, reliev i lartë, reliev i ulët, punim me gur, dekorim, gdhendje metali, stampimi, punim me gdhendje, zbukurim, etj.);
- *Matjet* (*Lartësia, gjerësia, thellësia dhe diametri në cm; pesha në kg*);
- *Formati*;
- *Autori* (nëse dihet shkruaj "nënshkruar nga ...", ose "i atribuohet ...", ose "Shkolla e ...", koha e ekzekutimit – shënimi shekullin dhe, nëse dihet, vitin);
- *Titulli i veprës së artit*;
- *Përshkrimi përmbledhës i pasurisë kulturore*;
- *Fotografi* ;
- *Shënime* (fushë për tekst të lirë për futjen e informacioneve me interes).

c) Në rast të rikuperimit/lokalizimit/sekuestrimit të trashëgimisë kulturore, objekt i kërkimit të përmendur në pikën a), **përditësoni sistemin kompjuterik** duke verifikuar paraprakisht nëse pasuria ndodhet në Bazën e të Dhënave. Nëse nuk është, duhet të gjenerohet një "ngjarje e re" për të pasur mundësi të hedhim "rikuperimin/lokalizimin/sekuestrimit". Pasi të jetë identifikuar pasuria që do të rikuperohet, operatori duhet të hedhë :

- **Datën** e rikuperimit;
- **Vendin** i rikuperimit;
- **Zyrën** që ka proceduar;
- **Vlerësimin** e vlerës së pasurisë (nëse ka);
- **Shënime** (fushë për tekst të lirë për informacion me interes).

d) në rast të fakteve tjera të tilla si:

- **gërmime të paligjshme të zbuluara**, duhet të krijohet një "ngjarje e re", në të cilën duhet të hidhen të dhënat e mëposhtme:

- **Lloji i ngjarjes** (ngjarje të tjera);
- **Kategoria e ngjarjeve** (gërmime të paligjshme);
- **Lloji i shkeljes** (administrative që lidhet me kërkimet dhe zbulimet e objekteve arkeologjike, në përputhje me pikën a) të nenit 260 i ligjit 27/2018);
- **Data e ngjarjes** (në lidhje me zbulimin);
- **Vendi i ngjarjes** (tregoni bashkinë dhe emrin e zonës arkeologjike);
- **Zyra Raportuese** (Mbikëqyrja, Policia, etj.);



## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

- **Shënime** (fushë për tekst të lirë për informacion me interes, siç janë koordinatat gjeografike të vendndodhjes së saktë të gërmimeve);
  - **Instrumentet e sekuestruara të kërkimit arkeologjik** (tregoni llojin dhe sasinë);
  - **Dokumentet:** merrni komunikimin/raportimin e Zyrës Raportuese në formatin pdf dhe futeni atë në sistemin e informacionit;
  - **Trashëgimia kulturore:** vetëm në rast të zbulimit të mallrave ose fragmenteve të tyre procedohet me hedhjen;
- **dëmtimi i trashëgimisë kulturore të paluajtshme** (monumente, ndërtesa historike), qoftë nga njeriu ose si rezultat i fatkeqësive natyrore, duhet të krijohet një "ngjarje e re", në të cilën duhet të futen të dhënat e mëposhtme:
- **Lloji i ngjarjes** (ngjarje tjera);
  - **Kategoria e ngjarjeve** (dëm i shkaktuar nga njeriu / shkaqet natyrore);
  - **Lloji i shkeljes** (specifikoni nëse është një krim);
  - **Data e ngjarjes** (në lidhje me ngjarjen);
  - **Vendi i ngjarjes** (tregoni bashkinë dhe vendin specifik: p.sh. kisha, monumenti, muzeu, ndërtesa historike, etj.);
  - **Zyra Raportuese** (Mbikëqyrja, Policia, etj.);
  - **Shënime** (fushë për tekst të lirë për informacion me interes);
  - **Dokumentet:** merrni komunikimin/raportimin e Zyrës Raportuese në formatin pdf dhe futeni atë në sistemin e informacionit;
  - **Pasuri kulturore:** shënoni vetëm nëse janë dëmtuar pasuri të vendosura brenda strukturës (p.sh. piktura, skulptura brenda muzeut).

Fusha tematike “**Kërkim/Konsultim**”: kushtuar kërkimit të dhënave të pranishme, si dhe krahasimit (automatik dhe manual) të imazheve (nëse ekzistojnë) të pasurisë kulturore të analizuar në Bazën e të Dhënave me ato që duhen verifikuar në bazë të raporteve (shoqëruar me fotografi) të institucioneve publike (Policia, Doganat, Mbikëqyrja, etj.) ose të paraqitura nga persona privatë përmes plotësimit të formularit të kërkesës, është e strukturuar duke respektuar të njëjtat fusha të përdorura në “**Regjistrimin e të Dhënave**”. Kjo bëhet pa cenuar mundësinë që operatori të përdorë fushën e kërkimit "tekst i lirë", e cila e lejon atë të ketë një gamë të gjerë të rezultateve.

Fusha tematike “**Statistikat**” i kushtohet përpunimit dhe analizës së të dhënave të mbledhura në bazë të përcaktimit të një periudhe kohore (data e fillimit/mbarimit) dhe përcaktimit të një zone të caktuar gjeografike të zgjedhur lirisht nga operatori, në lidhje me vjedhjen, humbjen e pasurisë në vijim të inventarit dhe gërmimeve klandestine të zbuluara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

Fusha tematike "**Administrimi**" i kushtohet nivelit më të lartë të menaxhimit të Bazës së të Dhënave nga Ministria e Kulturës, ushtruar nga Drejtori i IKRTK-së (ose i deleguari i tij). Në lidhje me këtë funksion, Drejtori:

- **Menaxhon** drejtpërdrejt profilet e aksesit të përdoruesve në sistem, duke dhënë autorizimin për të konsultuar dhe/ose krijuar "ngjarje të re" (me funksionin "Hedhja e të dhënave") në Bazën e të Dhënave, ose duke e revokuar atë në lidhje me nevojat e ndryshuara për shërbim dhe konfidencialitet të të dhënave të përfshira;
- **Autorizon** përdoruesit të gjenerojnë/fshijnë fushat të reja për hedhjen/modifikimin e "regjistrave tabelorë" të vendeve, zyrave, autorëve të trashëgimisë kulturore të rinj (që ndodh kur ekziston nevoja për të regjistruar një bashki/zyrë të re që nuk ndodhet në Bazën e të Dhënave, ose të një "autor të ri" të veprave të artit),
- **Siguron** hartimin e një "*Buletini Periodik të veprave të artit të vjedhura*", midis atyre që konsiderohen se meritojnë vëmendje më së shumti në lidhje me rëndësinë e tyre, të cilat mund të bëhen publike në format që konsiderohen të përshtatshme;
- **Autorizon** transmetimin e të dhënave në lidhje me veprat e artit që duhen kërkuar në Bazën e të Dhënave të INTERPOL.

**VI.VI Udhëzime për furnizimin e bazës së të dhënave pas kontrolleve të kryera në territor nga autoritetet doganore dhe policia e shtetit**

Operatori i Bazës së të Dhënave merr komunikime mbi kontrollet e kryera në territor dhe në internet mbi pronat kulturore të tregtuara nga tregtarët e antikeve, galeritë e artit, shtëpitë e ankandeve, si dhe ato të mbajtura nga persona fizikë që inspektohen në kufi në hyrje dhe dalje, me vërtetimin përkatës që autorizon eksportin/importin e tyre. Komunikimet e pasurisë kulturore të mbajtura/transportuar duhet të përmbajnë këto të dhëna:

- a) **karakteristikat përshkruese** të raportuara në modelin e njohur ndërkombëtarisht "OBJECT ID";
- b) **fotografi** (për qeramikën e dyanshme);

Komunikimet do të përfshijnë karakteristikat e mëposhtme:

- a) **Të dhënat e personit fizik** nën kontroll (Emri, Mbiemri, Vendi dhe Data e lindjes, Vendqëndrimi/vendbanimi, profesioni - tregtar antikitetesh/galerist/tregtar artesh, dokumenti i identitetit, kontaktet personale);





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

b) **Detaje të personit juridik** (p.sh. emrin dhe vendin e biznesit, numrin dhe llojin e licencës së tregtisë/shitjes dhe datën e lëshimit, shënimi nëse i janë vendosur penalitete të larta administrative/ penale)

Pasi të verifikohet plotësia e të dhënave të marra dhe në mungesë të gabimeve/mangësive/mospërputhjeve, **operatori i bazës së të dhënave** do të shënojë të dhënat:

a) **në lidhje me:**

- **Llojin e verifikimit** (kontrolli administrativ në vendndodhje, nga katalogu, nga faqja e internetit e shtëpive të ankandëve, etj.);
- **Enti Operues** (Policia e Shtetit, Doganat, Zyra e Eksporteve e Ministrisë së Kulturës);
- **Numri i fotografive;**
- **Periudha kohore** (DD / MM / VVVV i kontrollit);
- **Sanksionet/masat e marra** (sekuestrimi i mallrave, mbajtja e detyruar në ruajtje, sanksionet administrative, etj.);

b) në lidhje me **vendin e ngjarjes** (tregtari i antikeve, shtëpia e ankandit, galeria, aeroporti, pazar i hapur, etj);

c) në lidhje me **Dokumentin** (lloji - letra zyrtare, raporti, procesverbali -, numri i referencës së komunikimit, lënda, data, zyra që transmeton komunikimin) me marrjen më pas në *formatin pdf/word* të komunikimit/ raportit të Zyrës së dërguesit dhe hidheni atë në sistemin e informacionit;

d) në lidhje me pasurinë kulturore të kontrolluar:

- *Sasia (zakonisht 1 njëkohësisht);*
- *Konteksti i veprës (Paleontologjike, Arkeologjike, Antike, Moderne, Bashkëkohore);*
- *Lloji i objektit (Piktura, grafika, skulptura, gjetje arkeologjike, libër/dokument, arkiv/ dorëshkrim, mobilje te veçanta, etj.);*
- *Materiali (letër, dru, kanavacë, lloj metali, qelq, gur, pëlhurë, etj.);*
- *Teknika e punimit (vaj, temper, pastel, mozaik, serigrafji, litografi, media të përzier, lehtësim të lartë, lehtësim në bazë, punim me gur, dekorim, gdhendje druri, pllaka dysHEMEJE etj.);*
- *Matjet (Lartësia, gjerësia, thellësia dhe diametri në cm; pesha në kg);*
- *Formati ;*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

- Autori (nëse dihet shkruaj "nënshkruar nga ...", ose "i atribuohet ...", ose "Shkolla e ...", koha e ekzekutimit – shënoni shekullin dhe, nëse dihet, vitin);
- Titulli i veprës;
- Përshkrimi përmbledhës i pasurisë;
- Fotografia;
- Informacione të tjera (shënoni vlerën, mbulimin me sigurim dhe të dhënat në lidhje me pronarin e veprës nëse janë të ndryshme nga personi fizik/juridik i kontrolluar, etj.).

Për të siguruar gjurmueshmërinë e saktë të pasurisë kulturore që qarkullon lirshëm në territorin kombëtar dhe për të garantuar monitorim adekuat të rrugëve ligjore të **negocimit** të saj, është e rëndësishme që gjatë verifikimit/kontrollit të një biznesi me destinacion shitjen e mallrave antikë, veçanërisht nëse në emër të palëve të treta, kontrollorët kanë proceduar me kontrollin e regjistrimit ku janë regjistruar mallrat dhe i cili duhet të përmbajë fushat e mëposhtme:

- Numri Progresiv;
  - Të dhëna përshkruese të veprës së artit;
  - Detajet e plota të shitësit/blerësit/drejtuesit të shitjes dhe shënimin e të dhënave të dokumentit të vlefshëm të identitetit me fotografi.
- Shembull i nderverpimit me regjistrin e te dhenave Detaje të personit juridik  
*Parameter Hyres*  
<NIPT></NIPT>  
*Parameter Dales*  
<Nipt> </Nipt>  
  
<Emri\_Subjektit> </ Emri\_Subjektit >  
  
< Vendin e biznesit > </Vendin e biznesit >  
  
< Llojin e licencës së tregtisë > </Llojin e licencës së tregtisë >  
  
< Datën e lëshimit > </Datën e lëshimit >  
  
< penalitete administrative/ penale > </penalitete administrative/ penale  
  
< shënime ></ shënime >
  - Shembull i nderverpimit me regjistrin e te dhenave për të identifikuar personin fizik  
*Parameter Hyres*  
<NID></NID>  
*Parameter Dales*



## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

<Emer ></Emer >  
<Mbiemer></Mbiemer>  
<Datelindje></Datelindje>  
<Vendlindja></Vendlindja>  
< Vendqëndrimi ></ Vendqëndrimi >  
< Vendbanimi ></ Vendbanimi >  
< profesioni ></ profesioni >

### VII. PËRMIRËSIM I MODULEVE EGZISTUESE

Operatori ekonomik do të realizojë përmirësimin e moduleve ekzistuese të përshkruar si më poshtë:

#### VII.I Moduli i Objekteve me Leje me Afat Skadence

Operatori ekonomik do të realizojë përmirësimin e modulit të Objekteve me Leje me Afat Skadence. Në këtë modul afishohen të gjitha objektet e zhvendosura (për arsye të ndryshme: ekspozim, restaurim, etj.) për të cilat është tejkaluar afati i përcaktuar në dokumentin përkatës (urdhër ministri, vendim KKR, etj.)

Në këtë modul është e domosdoshme të krijohen raporte të ndryshme sipas:

- Poseduesit
- Lejes
- Datës
- Skeduesit

Operatori ekonomik do të saktësojë formatin dhe ndertimin e raporteve të sipercituara në modul të Objekteve me Leje me Afat Skadence përgjatë periudhës së implementimit.

#### VII.II Moduli i Transaksioneve

Operatori ekonomik do të realizojë përmirësimin e modulit të Transaksioneve, ku **aktualisht formati i transaksioneve është i njëjtë për të gjitha tipet e tyre.**

Në këtë modul duhen klasifikuar fushat sipas tipit të transaksionit në:

- Ekspozim
- Restaurim
- Lëvizje e Përkohshme
- Lëvizje e Përhershme
- Riprodhim

Gjithashtu të regjistrohet dhe emri i skeduesit për çdo transaksion dhe leje.



## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

### VII.III Moduli Raporte

Operatori ekonomik do të realizojë permiresimin e modulit të Raporteve, ku në këtë modul duhet të shtohet raportimi me grup kodesh si dhe raportimi sipas vendodhjes.

Operatori ekonomik do të saktësojë formatin dhe ndertimin e raporteve përgjate periudhes së implementimit.

### VII.IV Të tjera

Operatori ekonomik do të realizojë permiresimin e moduleve të tjera si dhe do të mundësojë krijimin e userave të tipit “Dogana” dhe “Policia”

Operatori ekonomik do të realizojë permiresimin tek të dhënat mbi objektin në zbatim të Titullit I “Pasuritë Kulturore” i pjesës së dytë Identifikimi, Mbrojtja dhe Vlerësimi i Pasurive Kulturore, nenet 50-68, fusha “Trashëgimi” ku kërkohe të ndryshohet në Pasuri e klasifikuar në:

- Vlerë Kulturore
- Pasuri Kulturore
- Thesar Kombëtar
- Pasuri Kulturore me Rëndësi Universale

Operatori ekonomik do të saktësojë formatin dhe natyrën e ndryshimeve të kerkuara përgjate periudhes së implementimit.

### **IKRTK SHËRBIMET ONLINE**

#### **SHËRBIMET AKTUALE QË OFROHEN NË PORTALIN E-ALBANIA**

1. Lëshim vërtetimi për objektet Pasuri Kulturore të regjistruara në Bazën e të Dhënave Shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)".
2. Aplikim për regjistrim, si dhe Aplikim për leje zhvendosje të veprave të arti.
3. Vlerësimi i objekteve të Trashëgimisë Kulturore të luajtshme, në pronësi private që dalin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### **SHËRBIMET E UNIFIKUARA NGA IKRTK JANË 8 SHËRBIME SË BASHKU ME FORMULARËT E SHËRBIMIT PËR SECILIN NGA SHËRBIMET E PARASHIKUARA:**

1. Aplikim për regjistrimin e objekteve pasurive kulturore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

2. Aplikim për pajisje me Certifikatën pasuri kulturore / Lëshimi i dublikatës së Certifikatës Pasuri Kulturore.
3. Aplikim për Verifikimin dhe Vlerësimin e interesit kulturor për pasuritë kulturore të luajtshme.
4. Aplikim për regjistrimin e objekteve muzeore dhe koleksioneve.
5. Aplikim për licencën e qarkullimit të lirë (eksportit) të pasurive kulturore.
6. Aplikim për licencën e qarkullimit të përkohshëm (eksportit) të pasurive kulturore.
7. Aplikim për licencën e importit të pasurive kulturore.
8. Aplikim për licencën e tregtimit të pasurive kulturore. (Shërbim i ri i shtuar, bazuar në VKM Nr. Nr. 199, date 31.03.2021 “Për kushtet e veçanta të licencimit, dokumentet shoqëruese, procedurat për rishikim ose revokim, tarifatat e aplikimit dhe tarifatat e kuotave vjetore të licencimit për tregtimin e pasurisë kulturore të luajtshme”).

Gjithashtu, projekti IPA i financuar nga BE-ja “Ngritja e kapaciteteve të Administratës Publike Shqiptare për Lëvizjen e Lirë dhe Luftën Kundër Trafikimit të Paligjshëm të Pasurive Kulturore”, aktualisht është duke punuar për draftimin dhe përfundimin e paktës së plotë të aktit ligjor i cili përfshin edhe formularët e aplikimit lidhur me shërbimet e parashikuara nga IKRTK.

### 1.2.c Sektori i financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

#### ❖ Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit

- ✓ Për vitin 2020, në zbatim të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020” dhe të Udhëzimit të MF nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, me shkresë të MK nr.590, datë 31.01.2020 “Dërgohet detajimi i fondeve për vitin 2020”, planifikuar në shumën 9.846.000 lekë dhe realizuar në shumën 7.925.630 lekë ose në masën 80.4%, ndryshuar gjatë vitit 2020.
- ✓ Në pasqyrën e mëposhtme, po japim buxhetin të ndarë sipas zërave me shumat përkatëse si dhe realizimin e tyre (në mijë/lekë).

Art	Emërtimi i shpenzimit	Viti 2020		
		Plan	Fakt	%
1.	Shpen. paga	6.209.000	5.936.253	96%
601	Shpen.sig.shoq.	1.037.000	986.855	95%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

602	<b>Shpen. operative</b>	2.500.000	972.328	39%
604	<b>Transf.brendshme</b>	0	0	0
605	<b>Transf.jashtë</b>	100.000	30.194	30%
	<b>Totali</b>	<b>9.846.000</b>	<b>7.925.630</b>	<b>80.4%</b>

- ✓ IKRTK mbështetur në nenin 43 “Detajimi i fondeve buxhetore” të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ka bërë detajimin e fondeve sipas nënzërave brenda limiteve të miratuara sipas të cilave nuk ka tejkalime të përdorimit të fondeve në total, apo shpenzimeve për nënartikuj.
- ✓ Pergatitja dhe dorezimi i pasqyrave permbledheseve, situacionet per vitin 2020 dorëzuar në Ministrinë e Kulturës dhe në Degën e Thesarit (tabela e të ardhurave shpenzimeve, situacioni permbledhes, 2 PU, 7 PU, 9 PU, tabela e investimeve Nr1, Nr.2, Nr3...etj).. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën 2020 të rakorduar me MK-në dhe degën e thesarit të Rrethit, Tiranë.
- ✓ Nga institucioni në zbatim të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu 1, pika 3/d, dh, dhe VKM nr 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, janë dërguar pranë Drejtorisë, Juridike dhe Marrëveshjeve rregjistrari i parashikimit të prokurimeve publike, ndryshimet gjatë vitit dhe realizimi i tyre, si dhe dërgimi i regjistrit të realizimeve të prokurimeve publike për vitin 2016, Në zbatim të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.
- ✓ Pergatitja i Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8, datë 27.02.2014 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm " për një zhvillim normal të aktivitetit të institucionit.
- ✓ Për vitin 2020 shpenzime operative nga buxheti i shtetit (602) janë përdorur, si më poshtë:

<b>Nr</b>	<b>Emetimi mall/sherbim/pune</b>	<b>Vlera ne lek</b>
1	Kancelari	119,640
2	Mat.për pastrim dhe shërb.	96,240
3	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres.	83,322
4	Mat.sherb.te tjera	287,760
5	Telefon,internet	16,889



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

6	Posta	4,430
7	Shërbime bankare	4,347
8	Shërbime pastrimi gjelbërimit	115,200
9	Udhëtim I brendshëm	16,500
10	Shpen.miremb.objek.spec.	228,000
	<b>Total:</b>	<b>972,328</b>

❖ *Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare*

- ✓ Për vitin 2020 veprimeve të kryera me arkë dhe bankë janë bërë në zbatim Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011” “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- ✓ Institucioni nuk ka krijuar të ardhura, mbështetur në VKM nr. 795, datë 26.11.2003 “Për ngritjen, përbërjen dhe mënyrën e funksionimit..të komisionit të përhershëm të vlerësimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, në pronësi private, të luajtëshme dhe për kriteret shkencore e procedura të vlerësimit të këtyre objekteve”, në zbatim të VKM nr.432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore” dhe udhëzimit të dala në zbatim të tij.

❖ *Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit*

- ✓ Për vitin 2020 mbajtja dhe funksionimi i sistemit kontabël është kryer sipas kërkesave të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe të rregullave kontabël”.
- ✓ Pergatitja dhe dorezimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (bilanci)te vitit 2020 është bere sipas formatit dhe procedurave te percaktuara ne në Udhezimin e Ministrisë te Financave nr.14 dt.28.12.2006, ndryshuar me Udhezimin nr.26 dt.27.12.2007 të Ministrisë te Financave “Per pergatitjen dhe raportimin e Pasqyrave Financiare Vjetore per Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njesive qe varen prej tyre..”.Rakorduar me Degene e Thesarit Tirane si dhe Derguar ne Ministrine e Kultures.

**2. TRAJNIME/SEMINARE/KONFERENCA : IKRTK JANAR - DHJETOR 2020**



## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

### ❖ **Konferencë Kombëtare**

**Titulli i aktivitetit:** Strategjia kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2022

**Organizatori:** Ministria e Brendshme

**Pjesëmarrësit:** Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara; Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes; Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike; Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare; Akademia e Sigurisë; Bashkimi Evropian; Byroja Kombëtare e Hetimit; Banka e Shqipërisë; Departamenti Amerikan i Shtetit; Dhoma Kombëtare e Avokatisë; Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Drejtoritë Vendore të Policisë; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Qendra Evropiane e Monitorimit të Narkotikëve dhe Varësisë nga Droga; Platforma multidisiplinare evropiane kundër kërcënimeve kriminale; Njësia për Kapjen e Personave në Kërkim; Task Forca e Veprimit Financiar; Fondi për Zhvillimin e Rajoneve; Grupet e krimin të organizuar; Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore; Institucione të Arsimit të Lartë; Këshilli i Lartë i Prokurorisë; Këshilli i Lartë Gjyqësor; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministria e Brendshme; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Drejtësisë; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; Ministria e Kulturës; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ndihmës specialist i policimit në komunitet; Prokuroria e Përgjithshme; Policia e Shtetit; Policia Ushtarake; Qendra për Ekstremizmin e Dhunshëm; Qendra Kombëtare e Biznesit; Shërbimi Informativ i Shtetit.

**Qëllimi dhe objektivat e konferencës:** Strategjia Kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda është hartuar në vijim të dy strategjive të mëparshme: Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimin të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2008-2013 dhe Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimin të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2013-2020. Kjo strategji përqëndrohet në luftën kundër krimin të organizuar dhe krimeve të rënda, duke u fokusuar në komponentët kryesorë të saj si: trafikimi i drogave, njerëzve, armëve, veprave të artit dhe trashëgimisë kulturore, pastrimi parave dhe strukturat e organizuara kriminale.

### **Problematikat:**

1. Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimin të organizuar dhe krimeve të rënda.
2. Goditja e veprimtarive kriminale
3. Goditja e trafikeve të paligjshme
4. Goditja e krimin ekonomik të pastrimit të parave





## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

5. Hetimi, ndjekja penale dhe dënimi i drejtuesve dhe anëtarëve të strukturave kriminale
6. Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar
7. Forcimi i marrëdhënieve juridikionale me autoritetet e huaja
8. Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë
9. Rritja e profesionalizmit
10. Dobësimi i motivit financiar në përfshirje në krim të organizuar
11. Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda
12. Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore
13. Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël

❖ **Projekte të financuara për periudhën : Janar - Dhjetor 2020 që përfshijnë, investime dhe mirëmbajtje financiar nga donatorë, projekte IPA, projekte të huaja etj).**

- Në kuadër të implementimit të akteve të reja nënligjore në zbatim të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” IKRTK dhe Ministria e Kulturës, ka aplikuar dhe përfituar projektin nga IPA Kombëtare me titull “Building capabilities of the Albanian Public Administration on free movement and fight against illicit trafficking of Cultural goods”.

Projekti ka për qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit vendas me Acquis of Bashkimit Evropian në fushën e luftës kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore, si dhe ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale dhe rritjen e ekspertizës të stafeve të administratës publike shqiptare përgjegjës për implementimin e procedurave për lëvizjen e lire të pasurive kulturore dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore, në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian, Rregulloret dhe legjislacionit vendas .

Projekti do të implementohet në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore përgjatë vitit 2019-2021.

Projekti përcakton dy komponent, të cilat shërbejnë për realizimin e qëllimit të përbashkët në luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore:

- Përafrimi i akteve ligjore dhe nënligjore shqiptare me atë të Unionit në fushën e luftës kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore dhe rishikimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Paligjshëm të Pasurive Kulturore.



## INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

- Trajnimi teknik i stafit të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të tjera të interesuara, përfshirë Doganat, Policinë, Interpolin dhe Prokurorinë.

Lidhur me aktet të cilat do të derivojnë nga ky proces, IKRTK ka ndjekur procesin deri në miratim, duke reflektuar komentet e secilave nga Ministrit e linjës.

Referuar akteve të tjera të cilat janë në proces, projekti ka pasur 2 shtyrje, njëra i referohet periudhës deri në fund të Shkurtit 2021, dhe shtyrja e fundit deri në Korrik 2021.

Gjithashtu në përfundim të projektit do përftohet paketa e plot ligjore referuar akteve fushë e përgjegjesisë së IKRTK-së.

### ❖ Konkluzione dhe Problematika

Nisur nga fakti se përgjatë vitit 2020 vendi ynë është ndeshur me faktorë sprovues të njëpasnjëshëm si fatkeqsi natyrore dhe pandemia globale Covid19, objektivat institucionalë dhe projektet kombëtarë apo ndërkombëtare janë realizuar të cunguar, sikurse disa prej tyre kanë mbetur pezull. Megjithatë jemi optimistë mbi angazhimin maksimal të institucionit dhe mbarëvajtjen e proceseve të punës. Institutit Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore gjykon se për shkaqe të ndryshme disa nga objektivat e nuk janë realizuar 100% dhe problematikat përkatëse janë sikurse vijon më poshtë:

- 1) Rishikim të organikës dhe strukturës pasi Sektori i Zyrave Rajonale të Regjistrimit, Eksportimit dhe Antitrafikut të Pasurive Kulturore referuar Urdhrit të Kryeministrit<sup>2</sup> ka vetëm dy specialistë dhe është e pamundur funksionimi i tyre në rang Republike.
- 2) Inspektimet në terren në përputhje me fushën e përgjegjesisë së IKRTK nuk janë realizuar plotësisht për shkak të kufizimeve të ndryshme dhe masave të marra në zbatim të protokolleve të sigurisë referuar pandemisë Covid19.
- 3) Funksionimi pranë IKRTK-s i Komisionit Këshillimor për Vlerësimin dhe Identifikimin e Vlerave Kulturore në pasuritë e luajtshme –Nuk ka ende një VKM mbi ngritjen dhe funksionimin e këtij këshilli pranë IKRTK.

---

<sup>2</sup> Në zbatim të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 432 datë 26.06.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore”, Urdhrit të Kryeministrit Nr. 136 datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore”, ushtron funksionet si Institutit Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

- 4) Krijimi dhe administrimi i Regjistrimit të Tregimit të Pasurive Kulturore- VKM nën proces miratimi.
- 5) Akordimi i licencave të eksportit dhe importit, si dhe krijimi dhe administrimi e regjistrimit kombëtar të licencave të eksportit të pasurive kulturore – VKM nën proces miratimi.